

## Rreth Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) është një organizatë me zyrë në Tiranë e pavarur, jo-fitimprurëse dhe jo-qeveritare, e themeluar në vitin 2000 dhe e fokusuar në analizën dhe kontributin në politikat publike në rang kombëtar dhe rajonal. Misioni i CDI është të kontribuojë në cilësinë e politikë-bërjes me hulumtim të hapur dhe bazuar në evidenca, advokim dhe debat. Nëpërmjet hulumtimit, publikimeve, eventeve dhe mediave sociale, CDI promovon një hapësirë unike debati për të gjithë ata që janë të interesuar në përmirësimin e cilësinë së politikë-bërjes.

### CDI hap thirrjen e rradhës për programin e praktikës në departamentet e mëposhtme:

- **“Departamenti i Kërkimit dhe i Komunikimit”**
- **“Departamenti i Administrim Menaxhimit”**

### Qëllimi i Praktikës:

- Dy aplikantët e përzgjedhur do të ofrojnë mbështetje për ekipin e CDI në:
  - punë kërkimore/hulumtuese;
  - mbështetje në zbatimin e projekteve të ndryshme;
  - angazhimi në aktivitete;
  - përgatitje e materialeve të komunikimit për mediat sociale;
  - shkrimi i artikujve të ndryshëm;
  - mbështetje administrative/logjistike për zyrën dhe detyra të tjera në varësi të interesit të vetë praktikantes apo praktikantit.
- Praktikanti ofron mbështetje operative në baza ditore me referencë të veçantë në zbatimin e projekteve në tre programet kryesore të Institutit si **“Mirëqeverisja”, “BE dhe Lidhshmëria” dhe “Rinia dhe Shoqëria”**.

### Çfarë ofron CDI:

- CDI fton të interesuarit për të aplikuar për një mundësi “praktike” me kohë të pjesshme për një periudhë nga 3 deri në max. 6 muaj në zyrën e CDI-s.
- Praktikanti/Praktikantja do mund të njihet nga afër me aktivitetin dhe disiplinën e punës në sektorin e organizatave jo-fitimprurëse (OJF/ NGO), të zgjerojë network-un nëpërmjet kontakteve me organizata e aktorë të tjerë, duke rritur mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tij/saj profesionale, si dhe do të mund të ketë një qasje të lirë për të përdorur dokumentet dhe botimet në bibliotekën e CDI.
- Në fund të praktikës, angazhimi dhe kontributi do të njihet me një Certifikatë Praktike dhe Letër Rekomandimi (nëse kërkohet).

## Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të jenë studentë të paktën në vitin e tretë të studimeve në nivelin Bachelor ose e preferueshme në vitin e parë të nivelit Masterit, në fusha si Shkenca Ekonomike, Studime Evropiane, Gazetari, Juridik ose të ngjashme;
- Të kenë interes në fushat e politikave publike, procesit të integritit evropian dhe Lidhshmërisë, dhe Qeverisjes së mirë;
- Aftësi të mira organizative, analitike dhe kërkimore;
- Të zotërojnë mjaft mirë gjuhën angleze (Niveli B2/mesatar). Njohja e mirë e gjuhës shqipe është e detyrueshme;
- Të kenë njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office;
- Njohje dhe familjaritet për përdorimin e rrjeteve sociale;
- Të jenë në gjendje për të punuar në ekip, por edhe në mënyrë të pavarur duke ndërmarrë iniciativë për kryerjen e detyrave.

*Shënim:* Një praktikë punë apo punësim i mëparshëm do të përbëjë avantazh në vlerësim.

## Afati i Aplikimit

Kandidatët e interesuar dhe që përmbushin kriteret e mësipërm janë të ftuar të dërgojnë në adresën e email-it [info@cdinstitute.eu](mailto:info@cdinstitute.eu) brenda datës **23 Maj 2021, ora 23:59**, dokumentat e mëposhtme në anglisht:

- **Një letër motivimi** (max. 350 fjalë);
- **CV** (në modelin e Europass);
- **Një punim apo detyrë kursi me karakter hulumtues;**

Çdo dokument duhet të ketë emrin e aplikantit/aplikantes dhe të jetë në formatin PDF si dhe subjekti i mesazhit të jetë: **“Aplikim për Praktikë-Emër Mbiemër.”**

\*Pas shqyrtimit të aplikimeve, vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për Intervistë. Për shkak të numrit të madhë të aplikimeve që CDI merr, do të kontaktohen vetëm kandidatët që ftohen për intervistë. Praktika do të fillojë në datën **1 Qershor 2021**.